



Titulli i projektit

Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të ambientit

Tipi i projektit

Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

NJQV Shijak, (Lumi Erzen, Liqeni Erzen, Burimet e Gjushit dhe Dushkut)

Buxheti i paravlerësuar

175,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Siç del qartë edhe nga studimi, Shijaku konsiderohet si një qytet me burime të pasura ujore. Lumi Erzenit, Liqeni i Erzenit, Burimi i Gjushit dhe Burimi i Dushkut janë të gjithë në territorin e tij. Këto burime janë potencialet natyrore më të rëndësishme turistike të zonës, duke ofruar vende të përshtatshme pushimi për popullsinë e saj dhe turistët potencialë.

Por mungesa shërbimit për grumbullimin e mbetjeve, derdhja e ujërave të zeza, papërgjegjshmëria e strukturave drejtuese dhe vetë komunitetit ndër vite, ka bërë që këto vende të vuajnë nga ndotja e mjedisit.

Adresimi i këtyre çështjeve, ndërgjegjësimi i autoriteteve lokale dhe komunitetit, pastrimi i këtyre vendeve, krijimi i një plani të përhershëm për menaxhimin dhe grumbullimin e mbetjeve, mund t'i kthejë këto resurse natyrore në atraksione turistike për vizitorët, burim për zhvillimin e turizmit dhe biznesit përkatës, etj..

Qëllimi/et specifik të projektit


Objekti i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes dhe menaxhimin të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor në Zonën Funksionale Shijak.

Kjo mund të arrihet duke sensibilizuar aktorët lokalë të pushtetit vendor, komunitetin dhe shoqërinë civile në lidhje me çështjet dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet aktiviteteve edukative, ndëhyrjeve në vendet e ndotura për rehabilitimin e tyre, krijimin e guidave turistike për promovimin e resurseve natyrore, etj..

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Nga ky projekt do të përfitonte kryesisht komuniteti i NJQV Shijak, me numër popullsie 7568 banorë. Në veçanti do të përfitonte komuniteti i biznesit të shërbimit (të tre kategoritë i vogël\mesëm\madh) por edhe bizneset e lidhura me shërbimin, pasi rehabilitimi i zonave të ndotura dhe promovimi i tyre do të krijonte premisat për zhvillimin e turizmit dhe rritjen e kërkesës për shërbime në këtë zonë, deri më tani inekzistent, me të paktën 1000 vizitorë që në vitin e parë.

Nga ana tjetër, shërbimet publike do të përmirësoheshin nën tryshinë e investimit të bërë, të komunitetit të biznesit dhe në bashkëpunim më këtë të fundit, do të përpunoheshin forma dhe mekanizma të reja për mbajtjen dhe rritjen e nivelit të pastrimit në zonë.



Aktivitetet e projektit

- Pastrimi i katër pikave të nxehta, tashmë të evidentuara si të ndotura, por me potenciale të konsiderueshme në zhvillimin e turizmit të zonës;
- Krijimi i një plani afatgjatë në bashkëpunim me biznesin lokal për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Krijimi i vendeve të përshtatshme për pushim\kamping;
- Mbjellja dhe pyllëzimi i zonave të dëmtuara;
- Promovimi i vlerave natyrore të zonës dhe përfshirja e tyre në axhendat e agjensive turistike;
- Ndërgjegjësimi i komunitetit, biznesit dhe autoriteve lokale për rëndësinë e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së ambientit të pastër, si një premisë e rëndësishme për zhvillimin e turizmit.

Kohëzgjatja e projektit parashikohet të jetë 20 muaj.

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimi i këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor, si institucioni përgjegjës për grumbullimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet për zhvillimin e rajoneve të Qeverisë Shqiptare.

Shoqëria civile, në partneritet me pushtetin vendor, do të ishte aktori më i përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti, duke marrë në konsideratë edhe përvojën e grumbulluar ndër vite dhe rolin e saj të natyrshëm në mbrojtjen e ambientit.

Kostot e projektit

Sipas renditjes së 6 aktiviteteve kryesore të përmendura më lart, kostot e përafërta do të ishin si më poshtë:

Pastrimi	30,000
Krijimi i planit afatgjatë	20,000
Krijimi i vendeve të përshtatshme për pushim\kamping dhe infrastrukturë mbështetëse	80,000
Mbjellja dhe pyllëzimi i zonave të dëmtuara	20,000
Promovimi i vlerave natyrore	20,000
Ndërgjegjësimi	5,000
Totali	175,000